

Njoftimi për përqendrim me të cilin MKG PROPERTIS LTD nga Qiproja do të fiton kontroll të vetëm mbi BLONDSTONE GROUP LIMITID nga Qiproja

(Lënda nr. 08-121 të vitit 2022)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 19 shtator 2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga MKG PROPERTIS LTD me seli të të regjistruar në The Oval, Office 502, Krinou 3, 4103 Agio Athanasios, Limasol, Qipro mbi BLONDSTONE GROUP LIMITID - Qipro me seli të regjistruar në Trident Center, Griva Digeni 115, 3101, Limasol-,Qipro, me anë të blerjes së të gjitha pjesëve.

- MKG PROPERTIS LTD është pjesë e Grupit MK i cili është aktiv në fushat e bujqësisë, financave, turizmit dhe energjisë. MKG PROPERTIS LTD nuk ka shoqëri të varura të cilët janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por është aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes departamentit të saj të bujqësisë.

- BLONDSTONE GROUP LIMITID, së bashku me shoqëritë e saja të lidhura, është aktive në fushën e turizmit, gjegjësisht e hotelierisë në Serbi. BLONDSTONE GROUP LIMITID nuk ka shoqëri të varura apo aktivitete në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke marrë parasysh tregun të cilit i referohet Transaksioni, tregu relevant, për qëllimet e këtij Njoftimi, mund të përkufizohet si treg i ofrimit të shërbimeve për akomodim në hotele, në hotele luksoze në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.09.2022

Shkup